



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 25 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i
Vendimit të Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)**

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit:

Julius von Bone

Zyrës Administrative:

Shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së
Viktimave

Zilke Shtuxhinski

Mbrojtëses së viktimave:

Ani Puz

TRUPI GJYKUES I (“Trupi Gjykues”) nxjerr këtë vendim të dytë mbi caktimin e ekspertit (ekspertëve).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykues nxori “Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)” (“Vendimi”), me të cilin urdhëroi Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave (“ZPV”) që deri të premtën, 4 qershor 2021, të parashtronte një listë me tre ekspertë përkatës, të disponueshëm brenda një kohe të shkurtër, për përgatitjen e aktekspertizës së përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit.¹ Gjithashtu, Trupi Gjykues urdhëroi mbrojtësin e të akuzuarit dhe mbrojtësen e viktimave që të dorëzonin parashtrimet e tyre, brenda dhjetë (10) ditësh nga njoftimi i parashtrimit të ZPV-së.²

2. Më 4 qershor 2021, Administratorja dorëzoi “Parashtrimin e Zyrës Administrative në Përputhje me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)”, në të cilin ZPV-ja identifikoi tre ekspertë që “plotësojnë mjaftueshmërisht kushtet” e përcaktuara në Vendim.³

3. Më 14 qershor 2021, mbrojtësja e viktimave dorëzoi “Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)” (“Parashtrimet e Viktimave”).⁴

4. Mbrojtja e Salih Mustafës (“i akuzuari”) nuk dorëzoi parashtrime.

¹ KSC-BC-2020-05, F00124, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 20 maj 2021, publik, para. 24(a).

² Vendimi, para. 24(b).

³ KSC-BC-2020-05, F00132, Administratorja, *Parashtrim i Zyrës Administrative në Përputhje me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (“Parashtrimet e Zyrës Administrative”), 4 qershor 2021, publik, me Shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00134, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 14 qershor 2021, publik.

II. PARASHTRIMET

5. ZPV-ja parashtron se ka kontaktuar një numër avokatësh, juristësh, ekspertësh dhe organizatash në Kosovë.⁵ Në vijim të atyre konsultimeve, ZPV-ja identifikoi tre kandidatë potencialisht të përshtatshëm, të disponueshëm brenda një kohe të shkurtër, për shqyrtim nga Paneli.⁶

6. Mbrojtësja e viktimave parashtron se Trupi Gjykes duhet të rishqyrtojë nevojën për caktimin e ekspertëve për të raportuar lidhur me padi private të mundshme në Kosovë për zhdëmtim për dëmin e pësuar.⁷ Ajo argumenton se gjatë 22 viteve, viktimave pjesëmarrëse nuk u është ofruar asnjë mjet juridik efektiv.⁸ Për këtë arsye, Trupit Gjykes i kërkohet që vetë t'i trajtojë këto shkelje, dhe në rast se i akuzuari shpallet fajtor, të nxjerrë një urdhër për zhdëmtim.⁹ Rrjedhimisht, mbrojtësja e viktimave vlerëson se është më mirë që Trupi Gjykes të caktojë ekspert (ekspertë) për të ndihmuar në përgatitjen e urdhrave për zhdëmtimin e viktimave në këtë çështje gjyqësore.¹⁰

7. Mbrojtësja e viktimave gjithashtu parashtron se me gjithë përvojën e gjerë dhe të larmishme profesionale të tyre, asnjëri nga tre ekspertët e propozuar nuk ka ekspertizën konkrete dhe specifike të nevojshme për përgatitjen e aktekspertizës mbi temat e identifikuara në Vendim.¹¹ Së fundi, sipas mbrojtëses së viktimave vetëm njëri nga tre ekspertët e propozuar ka “përvojën e duhur praktike” që mund të ndihmojë në përgatitjen e një aktekspertize, ndërsa një tjetër ka në një masë ekspertizën

⁵ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 7.

⁶ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 8.

⁷ Parashtrimet e Viktimave, para. 13-17, 37.

⁸ Parashtrimet e Viktimave, para. 15.

⁹ Parashtrimet e Viktimave, para. 16.

¹⁰ Parashtrimet e Viktimave, para. 37.

¹¹ Parashtrimet e Viktimave, para. 18-20.

përkatëse, por vetëm për një pjesë të vogël të pyetjeve në lidhje me të drejtën private që duhet të diskutohen.¹²

III. ANALIZË

8. Trupi Gjykses vëren se ZPV-ja ka propozuar për shqyrtim tre ekspertë nga Kosova, të cilët - sikurse theksohet në Parashtrimet e Viktimave - kanë përvojë përkatëse të pjesshme për sa i përket dijenisë dhe përvojës specifike që parashtron Trupi Gjykses në Vendimin e vet, si p.sh. për "funksionimin e sistemit juridik të Kosovës lidhur me kërkesat për kompensim të parashtruara nga viktimat e proceseve të krimeve të luftës të ngjashme me procesin aktual".¹³

9. Pa cenuar caktimin e mundshëm të cilitdo prej ekspertëve të propozuar, Trupi Gjykses e gjykon të arsyeshme të urdhërojë ZPV-në që deri të mërkurën, 12 korrik 2021, të propozojë për shqyrtim nga Trupi Gjykses edhe ekspertë të tjerë. Në veçanti, duke pasur parasysh se tanimë ka marrë për shqyrtim profilet e tre kosovarëve, Trupi Gjykses e vlerëson të nevojshme që ZPV-ja të propozojë edhe tre ekspertë përkatës të tjerë që nuk janë nga Kosova, të cilët mundësisht i plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 22 të Vendimit për përgatitjen e aktekspertizës të përshkruar në paragrafin 20 të Vendimit. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses e gjykon të arsyeshme të urdhërojë ZPV-në që krahas ekspertëve të tjerë që mund t'i konsiderojë të përshtatshëm, të kontaktojë [REDAKTUAR] për [REDAKTUAR] pyetur nëse [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] brenda një kohe të shkurtër për të përgatitur aktekspertizën e përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit.

¹² Parashtrimet e Viktimave, para. 18-20.

¹³ Vendimi, para. 20, 22.

10. Gjithashtu, Trupi Gjykues e gjykon të arsyeshme të urdhërojë ZPV-në që deri më të njëjtën datë, të kontaktojë [REDAKTUAR], në lidhje me gatishmërinë dhe disponueshmërinë [REDAKTUAR] brenda një kohe të shkurtër për të përgatitur aktekspertizën e përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit. Për këtë qëllim, ZPV-ja mund t'ia përcjellë këtë vendim [REDAKTUAR]. Në qoftë se [REDAKTUAR] aktekspertizën e kërkuar, por nuk [REDAKTUAR] në gjendje ta [REDAKTUAR] këtë brenda një kohe të shkurtër, ZPV-ja duhet ta informojë Trupin Gjykues për sa më sipër dhe për kohën kur [REDAKTUAR] do të [REDAKTUAR] në gjendje të [REDAKTUAR] aktekspertizën në fjalë.

11. Mbrojtësi i të akuzuarit dhe mbrojtësja e viktimave ftohen të paraqesin parashtrimet e tyre lidhur me listën e dorëzuar të ekspertëve dhe të propozojnë pyetje (të tjera) të cilat eksperti ose ekspertët që përfundimisht do të përzgjidhen nga Trupi Gjykues, duhet të trajtojnë në raportin e tyre. Duke pasur parasysh pushimin veror të gjykatës,¹⁴ parashtrimet duhet të dorëzohen deri të premten, 20 gusht 2021. Më pas, Trupi Gjykues do të vijojë me caktimin dhe udhëzimin e ekspertit ose ekspertëve të përzgjedhur. Trupi Gjykues nënvizon se ka marrë parasysh listën e gjerë të pyetjeve të propozuara nga mbrojtësja e viktimave.¹⁵

1. VENDIM

12. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **URDHËRON** ZPV-në që deri të **mërkurën, 21 korrik 2021**, të parashtrojë:
 - (i) listën e ekspertëve përkatës, në përputhje me paragrafin 9 më sipër, të disponueshëm brenda një kohe të shkurtër për përgatitjen e aktekspertizës së përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit; dhe
 - (ii) raportin mbi

¹⁴ Pushimi veror i gjykatës është nga dita e hënë, 26 korrik 2021, deri ditën e premte, 13 gusht 2021, *shih* KSCPR-2020, Kryetarja, *Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2021*, 10 nëntor 2020, publik.

¹⁵ *Shih* Parashtrimet e Viktimave para. 24-26, 30-36.

gatishmërinë dhe disponueshmërinë e [REDAKTUAR] për përgatitjen e aktekspertizës së përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit, sikurse specifikohet në paragrafin 10 më sipër; dhe

- b. **URDHËRON** mbrojtësin e të akuzuarit dhe mbrojtësen e viktimave të dorëzojnë parashtrimet e tyre lidhur me parashtrimet e ZPV-së, në qoftë se kanë, deri të **premtën, 20 gusht 2021**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premtë, 25 qershor 2021
Hagë, Holandë.